

Në bazë të nenit 47, paragrafit 1, pikës 6 të Ligjit për Bankën Popullore të Republikës së Maqedonisë ("Gazeta Zyrtare e Republikës së Maqedonisë" nr. 158/10, 123/12, 43/14, 153/15 dhe 6 /16) dhe nenit 114, paragrafit 2 të Ligjit për bankat ("Gazeta Zyrtare e Republikës së Maqedonisë" nr. 67/07, 90/09, 67/10, 26/13, 15/15, 153/15 dhe 190/16), Këshilli i Bankës Popullore të Republikës së Maqedonisë miratoi

VENDIM

për mënyrën e kryerjes së supervizionit dhe mbikëqyrjes ("Gazeta Zyrtare e Republikës së Maqedonisë" nr. 58/18)

I. DISPOZITA TË PËRGJITHSHME

1. Me këtë vendim përcaktohet mënyra se si Banka Popullore e Republikës së Maqedonisë (në tekstin e mëtejme: Banka Popullore) kryen supervizion të një banke (në tekstin e mëtejme: supervizion) dhe mbikëqyrje të operacioneve të personave të lidhur me bankën, personave të tjerë në grupin bankar dhe të shoqërisë për shërbime bankare ndihmëse (në tekstin e mëtejme: mbikëqyrje).

2. Persona të autorizuar, sipas këtij vendimi, janë personat e punësuar në Bankën Popullore dhe të cilët janë të autorizuar nga guvernatori për të kryer supervizion dhe mbikëqyrje, në pajtim me aktet e brendshme të Bankës Popullore.

3. Për shprehjet e veçanta të përdorura në këtë vendim zbatohet kuptimi i termave i përcaktuar me Ligjin për bankat dhe me aktet nënligjore të miratuara në bazë të këtij ligji.

II. MËNYRA E KRYERJES SË SUPERVIZIONIT

4. Banka Popullore e kryen supervizionin nëpërmjet:

- monitorimit të përhershëm të jashtëm të operacioneve të bankës duke i mbledhur dhe analizuar raportet dhe të dhënat e dorëzuara nga banka (në tekstin e mëtejme: supervizion i jashtëm), në përputhje me kreun III të këtij vendimi;
- kontrollit të drejtpërdrejtë, të plotë ose të pjesshëm në terren në vetë bankën (në tekstin e mëtejme: supervizion në teren), në përputhje me kreun IV të këtij vendimi;
- mbajtjes së kontakteve me anëtarët e organeve të bankës dhe me shoqërinë për auditim, në përputhje me kreun V të këtij vendimi, dhe
- bashkëpunimit dhe shkëmbimit të të dhënave dhe informacionit me organe të tjera për supervizion, në përputhje me kreun VI të këtij vendimi.

5. Banka Popullore e vlerëson besueshmërinë, qëndrueshmërinë, rrezikun dhe përputhshmërinë e veprimtarisë së bankës me rregulloret, kështu që nëpërmjet supervizionit nga pika 4 e këtij vendimi vlerësohet së paku:

- plotësimi i kërkesave për kryerjen e veprimtarive bankare dhe financiare;
- përputhshmëria e operacioneve të bankës me rregulloret që e rregullojnë veprimtarinë e bankës ose me politikat dhe aktet e brendshme të saj;

- modeli i biznesit të bankës, përkatësisht natyra, lloji dhe shtrirja e aktiviteteve financiare të kryera nga banka dhe rreziqet ndaj të cilave ajo është ekspozuar ose mund të ekspozohet si rezultat i këtyre aktiviteteve, duke i përfshirë rreziqet që rrjedhin nga mjedisi makroekonomik;
- ndikimi i bankës në ruajtjen ose përkeqësimin e sigurisë dhe stabilitetit të sistemit bankar në tërësi;
- përshtatshmëria e raportit të mjaftueshmërisë së kapitalit të bankës, duke i marrë parasysh politikën e biznesit të bankës, profilin e saj të rrezikut dhe kërkesat për ruajtjen e shtresave mbrojtëse të kapitalit;
- përshtatshmëria e gjendjes së likuiditetit dhe pozicionit fitimprurës të bankës;
- respektimi i standardeve të supervizionit të përcaktuara me Ligjin për bankat, aktet nënligjore të miratuara në bazë të këtij ligji ose në bazë të masës së marrë nga guvernatori i Bankës Popullore, në pajtim me Ligjin për bankat;
- drejtimi i vendosur korporativ në bankë dhe respektimi i rregullave të drejtimit të mirë korporativ;
- përshtatshmëria e sistemit të kontrollit të brendshëm, duke e përfshirë përshtatshmërinë e tre funksioneve të kontrollit;
- përshtatshmëria e sistemit për parandalimin e pastrimit të parave dhe financimit të terrorizmit;
- zbatimi i standardeve të kontabilitetit, veçanërisht nga aspekti nëse banka i ka përgatitur raportet financiare në përputhje me rregulloret në fuqi për raportim financiar;
- dorëzimi në kohë i raporteve dhe i të dhënave në Bankën Popullore dhe nëse raportet dhe të dhënat janë përpiluar në përputhje me rregulloret që e rregullojnë punën e bankave;
- mënyra e kryerjes së auditimit nga shoqëria audituese, si dhe përshtatshmëria e raportit për auditim të raporteve financiare vjetore të bankës dhe të operacioneve të bankës.

6. Banka është e detyruar, në përputhje me procedurat e saj të sigurisë, t'u sigurojë personave të autorizuar qasje në të gjitha ambientet, t'u sigurojë qasje në të gjithë dokumentacionin në dispozicion, përfshirë të dhënat e ruajtura në mënyrë elektronike, si dhe ta sigurojë dokumentacionin dhe informacionin e kërkuar nga personat e autorizuar.

Gjatë kryerjes së supervizionit të përmendur në pikën 4 të këtij vendimi, me kërkesë të personave të autorizuar, anëtarët e bordit drejtues të bankës dhe personat e tjerë me të drejta dhe përgjegjësi të veçanta në bankë janë të detyruar t'ua paraqesin personave të autorizuar përgjigjet, së bashku me provat e dokumentuara, për të gjitha pyetjet që kanë rëndësi për zbatimin e tij.

7. Nëse banka përdor shërbime nga shoqëritë për shërbime bankare ndihmëse, ajo është e detyruar t'u sigurojë personave të autorizuar qasje në objektet e kompanisë së shërbimeve bankare ndihmëse, kontroll mbi të gjithë dokumentacionin në dispozicion, përfshirë të dhënat e ruajtura në mënyrë elektronike, si dhe ta sigurojë dokumentacionin dhe informacionin e kërkuar nga personat e autorizuar për nevojat e kryerjes së supervizionit të Bankës Popullore.

III. SUPERVIZIONI I JASHTËM

8. Supervizioni i jashtëm kryhet nëpërmjet mbledhjes së raporteve dhe të dhënave për bankën dhe analizës së tyre nga personat e autorizuar, për efekt të kryerjes së vlerësimit të përmendur në pikën 5 të këtij vendimi.

Raportet dhe të dhënat nga paragrafi 1 i kësaj pike i përfshijnë raportet dhe të dhënat që banka është e detyruar t'ia dorëzojë Bankës Popullore, raportet dhe të dhënat e marra nga shoqëria e auditimit që e ka kryer auditimin e raporteve financiare vjetore dhe veprimtarinë e bankës (në tekstin e mëtejshëm: shoqëria e auditimit), komunikimin me shkrim ndërmjet bankës dhe personave të autorizuar, si dhe çdo raport dhe të dhënë tjetër të disponueshme në lidhje me bankën dhe/ose aksionarët e saj.

9. Në bazë të analizës së përmendur në pikën 8 të këtij vendimi, si dhe në bazë të rezultateve të inspektimeve në terren të kryera në përputhje me kreun IV të këtij vendimi, personat e autorizuar e përcaktojnë profilin e përgjithshëm të rrezikut të bankës, i cili përfshin një vlerësim të:

- modelit të biznesit;
- drejtimit korporativ;
- gjendjes së likuiditetit dhe
- rreziqet për pozicionin e kapitalit të bankës (të paktën rrezikun kreditor, operacional, valutor dhe rrezikun e ndryshimeve të normave të interesit në portofolin e aktiviteteve bankare).

10. Në bazë të profilin të përgjithshëm të rrezikut të përcaktuar të bankës, personat e autorizuar e përgatisin planin e veprimtarive të supervizionit për bankën, nëse është e nevojshme, i propozojnë bankës masa dhe të paktën një herë në vit e vlerësojnë nevojën për përcaktimin e normave më të larta se ato të parashikuara në nenin 65, paragrafët 1 dhe 2 të Ligjit për bankat (në tekstin e mëtejshëm: niveli minimal i nevojshëm i kapitalit).

Gjatë përcaktimit të nivelit minimal të nevojshëm të kapitalit, merren parasysh edhe rreziqet e pranishme në operacionet e bankës, që mund të kenë ndikim në ruajtjen ose prishjen e sigurisë dhe stabilitetit të sistemit bankar në tërësi dhe rezultatet e stres-testeve të kryera nga banka dhe/ose Banka popullore, duke e marrë parasysh modelin e biznesit të bankës.

Përcaktimi i nivelit minimal të nevojshëm të kapitalit mund të bëhet edhe në një periudhë më të shkurtër se një vit, nëse është e nevojshme për shkak të natyrës, llojit dhe vëllimit të aktiviteteve të kryera nga banka dhe rreziqeve ndaj të cilave është e ekspozuar si rezultat i këtyre aktiviteteve.

11. Personat e autorizuar janë të detyruar të përgatisin raport për nivelin minimal të nevojshëm të kapitalit, që banka duhet ta mbajë në vitin pasardhës, në të cilin jepet shpjegim i profilin të përgjithshëm të rrezikut mbi bazën e të cilit është përcaktuar niveli minimal i kërkuar i kapitalit, si dhe diferencat e mundshme ndërmjet kapitalit të brendshëm të bankës, të përcaktuar në përputhje me rregulloren e Bankës

popullore për menaxhimin e rrezikut, dhe nivelin minimal të nevojshëm të kapitalit, të përcaktuar në përputhje me këtë vendim.

Personat e autorizuar janë të detyruar që raportin për nivelin minimal të nevojshëm të kapitalit t'ua dorëzojnë anëtarëve të bordit drejtues të bankës, së cilës i referohet ai raport.

12. Banka mund t'i paraqesë vërejtje Bankës Popullore për raportin për nivelin minimal të nevojshëm të kapitalit, brenda një periudhe të caktuar nga Banka Popullore, e cila nuk mund të jetë më e shkurtër se tetë ditë e as më e gjatë se pesëmbëdhjetë ditë nga data e pranimi të raportit për nivelin minimal të nevojshëm të kapitalit.

Për shqyrtim më të detajuar të vërejtjeve nga paragrafi 1 i kësaj pike dhe/ose për harmonizimin e qëndrimeve në lidhje me nivelin minimal të nevojshëm të kapitalit që duhet të mbajë banka në vitin e ardhshëm, Banka Popullore mund të organizojë takim me bankën.

13. Në bazë të raportit për nivelin minimal të nevojshëm të kapitalit, që banka duhet ta mbajë në vitin e ardhshëm dhe vëzhgimet dhe takimin e përmendur në pikën 12 të këtij vendimi, jo më vonë se 15 dhjetori i vitit aktual, guvernatori i Bankës Popullore do të miratojë vendim për arritjen ose ruajtjen e një sasive më të madhe të mjeteve të veta dhe/ose të një raporti më të lartë të mjaftueshmërisë së kapitalit ose ndërmerr masa të tjera në përputhje me Ligjin për bankat.

Në rastet nga pika 10, paragrafi 3 i këtij vendimi, guvernatori i Bankës Popullore do ta miratojë vendimin ose do t'i marrë masat nga paragrafi 1 i kësaj pike brenda tridhjetë ditëve nga data e paraqitjes së raportit për nivelin minimal të nevojshëm të kapitalit.

IV. SUPERVIZIONI NË TEREN

14. Supervizioni i bankës në terren e përfshin:

- kontrollin në terren në bankë, nëpërmjet të cilit vlerësohet siguria, qëndrueshmëria, rrezikshmëria e operacioneve dhe përputhshmëria e veprimeve të bankave me rregulloret;
- mbikëqyrjen e zbatimit të rregulloreve (në tekstin e mëtejshëm: kontroll inspektues).

Supervizionin në terren, nga paragrafi 1 i kësaj pike, e kryejnë personat e autorizuar në bazë të autorizimit me shkrim nga guvernatori i Bankës Popullore për kryerjen e kontrollit në terren ose të kontrollit inspektues në bankë.

15. Banka është e detyruar të sigurojë kushtet teknike të përshtatshme për kryerjen e inspektimit në terren, para së gjithash për sigurimin e hapësirës së përshtatshme në bankë për personat e autorizuar të përmendur në pikën 14, paragrafin 2 të këtij vendimi, në të cilën mund të kufizohet qasja fizike, si dhe sigurimi i qasjes në internet dhe në pajisje të tjera IT të kërkuara nga personat e autorizuar.

Kontrolli në terren

16. Kontrolli në terren kryhet nëpërmjet:

- shqyrtimit të dokumentacionit të biznesit dhe kontabilitetit, raporteve dhe të dhënave për bankën, politikave dhe akteve të brendshme të bankës dhe dokumentacionit tjetër që lidhet me veprimtarinë e bankës, i cili është në dispozicion të personave të autorizuar ose që kërkohet nga personat e autorizuar;
- kontrollimit të aftësive profesionale, organizative dhe teknike të bankës;
- shpjegimeve me shkrim ose me gojë të marra nga persona me të drejta dhe përgjegjësi të veçanta dhe nga punonjës të tjerë të bankës.

Kontrolli në terren mund ta përfshijë të gjithë funksionimin e bankës (kontrolli i plotë në terren) ose të përfshijë vetëm një pjesë të caktuar të funksionimit të bankës (kontrolli i pjesshëm në terren).

17. Kontrolli në terren i bankës kryhet sipas planit të paracaktuar për kontrolle në terren, të miratuar nga guvernatori i Bankës Popullore.

Plani për kontrolle në terren nga paragrafi 1 i kësaj pike përpilohet në bazë të profileve të përgjithshme të rrezikut dhe planit të aktiviteteve të supervizionit të përcaktuara përmes supervizionit jashtë terrenit të bankave, si dhe në bazë të rreziqeve të sistemit, të pranishme në sistemin financiar të Republikës së Maqedonisë dhe/ose në shtetin në të cilin ndodhet subjekti amë ose filiali/filialet e bankës.

Me përjashtim të paragrafit 1 të kësaj pike, kontrolli në terren i bankës kryhet sipas nevojës në rastet e mëposhtme:

- nëse, nëpërmjet supervizionit të jashtëm, konstatohet përkeqësim i tendencave në operacionet e bankës, i cili mund të ndikojë negativisht në sigurinë dhe stabilitetin e saj dhe/ose në sigurinë dhe stabilitetin e sistemit bankar;
- nëse është e nevojshme, kontrollohen edhe veprimet e bankës në lidhje me masat e ndërmarra nga guvernatori i Bankës Popullore dhe
- me qëllim të grumbullimit, përpunimit dhe analizimit të të dhënave të nevojshme për kryerjen e funksioneve të Bankës Popullore.

18. Banka Popullore i dërgon njoftim bankës se planifikon të bëjë kontroll në terren, jo më vonë se tridhjetë ditë para fillimit të kontrollit në terren të bankës. Njoftimi përmban:

- informacion në lidhje me lëndën e kontrollit,
- informacione për personin e autorizuar që do ta drejtojë kontrollin,
- datën e fillimit të kontrollit;
- kohëzgjatjen e planifikuar të kontrollit,
- listën e informacionit që duhet ta përgatitë banka për qëllimet e kontrollit.

Në njoftimin nga paragrafi 1 i kësaj pike shënohen edhe afatet brenda të cilave duhet të përgatitet informacioni përkatës dhe t'u dorëzohet personave të autorizuar nga pika 14, paragrafi 2 i këtij vendimi.

Informacionet që banka duhet t'i përgatisë për nevojat e kontrollit duhet të jenë të plota, të sakta dhe përfundimtare dhe banka nuk duhet t'i ndryshojë ato gjatë kontrollit.

19. Me përjashtim të pikës 18 të këtij vendimi, para fillimit të kontrollit në terren nga pika 17, paragrafi 3 i këtij vendimi, Banka Popullore nuk është e obliguar t'i dërgojë njoftim bankës se planifikon të kryejë kontroll në terren.

20. Nëse gjatë kontrollit në terren konstatohet se ka nevojë për zgjerimin e lëndës së inspektimit, në përputhje me rregullat e brendshme të miratuara nga guvernatori i Bankës Popullore, personat e autorizuar do të kërkojnë nga guvernatori i Bankës Popullore ndryshimin dhe plotësimin e autorizimit me shkrim për kryerjen e kontrollit në terren.

21. Banka Popullore mund të mos e fillojë ose ta ndërpresë zbatimin e kontrollit në terren nëse:

- të dhënat dhe informacionet e kërkuara nuk janë përgatitur në përputhje me afatet e përcaktuara në njoftimin e përmendur në pikën 18 të këtij vendimi;
- kontrolli vështirësohet për shkak të evidencës së çrregullt, mungesës ose mosdorëzimit të dokumentacionit, mungesës së bashkëpunimit ose bashkëpunimit të pamjaftueshëm me organet e bankës;
- në çfarëdo mënyre tjetër pengohet kryerja e kontrollit.

22. Pas kontrollit të plotë ose të pjesshëm në terren, personat e autorizuar nga pika 14, paragrafi 2 i këtij vendimi përpilojnë procesverbal për kontrollin e kryer, në pajtim me rregullat e brendshme të miratuara nga guvernatori i Bankës Popullore.

Procesverbali nga paragrafi 1 i kësaj pike i përmban këto elemente:

- vëzhgime përmbyllëse për fusha të veçanta të përfshira me kontrollin në terren;
- shqyrtim të detajuar të të gjitha gjetjeve gjatë kontrollit që kanë të bëjnë me dobësitë apo parregullsitë e identifikuara në funksionimin e bankës;
- gjetjet që paraqesin mosrespektim të legjislacionit përkatës;
- reagimin e bankës ndaj masave të shqiptuara më parë nga Banka Popullore.

Me përjashtim të paragrafit 1 të kësaj pike, për kontrollet në terren nga pika 17, paragrafi 3, alineja 3 e këtij vendimi, personat e autorizuar nga pika 14, paragrafi 2 i këtij vendimi përgatisin raport që nuk i dorëzohet bankës.

23. Procesverbali i kontrollit të kryer përbën sekret profesional të Bankës Popullore dhe banka është e detyruar ta ruajë atë. Banka mund ta citojë ose në ndonjë mënyrë tjetër ta specifikojë përmbajtjen e procesverbalit të kontrollit vetëm për qëllime të auditimit të raporteve financiare vjetore dhe librave tregtarë, për një analizë të thelluar të bankës dhe në rastet e tjera të parashikuara me ligj, pas miratimit të mëparshëm me shkrim nga guvernatori i Bankës Popullore.

24. Procesverbalin e kontrollit të kryer u dërgohet anëtarëve të bordit drejtues të bankës.

Anëtarët e bordit drejtues të bankës janë të detyruar ta shqyrtojnë procesverbalin e kontrollit të kryer, t'i informojnë anëtarët e këshillit mbikëqyrës për përmbajtjen e tij dhe një kopje t'ia dorëzojnë Shërbimit për Auditim të Brendshëm.

25. Banka që i është nënshtruar kontrollit në teren ka të drejtë të kundërshtojë procesverbalin e kontrollit të kryer, duke dhënë shpjegim me prova të dokumentuara për konstatimet që i konsideron të pabazuara ose që nuk korrespondojnë me gjendjen reale në bankë. Banka do ta paraqesë kundërshtimin në Bankën Popullore në afatin e caktuar nga Banka Popullore e Republikës së Maqedonisë, i cili nuk mund të jetë më i shkurtër se tetë ditë e as më i gjatë se pesëmbëdhjetë ditë nga dita e pranimi të procesverbalit.

Së bashku me kundërshtimin nga paragrafi 1 i kësaj pike, banka duhet që detyrimisht ta paraqesë planin e aktiviteteve që banka do të ndërmarrë për eliminimin e dobësive apo parregullsive të konstatuara në funksionim dhe afatet e zbatimit të tyre.

26. Personat e autorizuar janë të detyruar ta shqyrtojnë kundërshtimin e bankës për procesverbalin e kontrollit të kryer dhe të përgatisin përgjigje ndaj kundërshtimit, në të cilin deklarohen për (mos)pranimin e shpjegimeve të veçanta të bankës për gjetjet nga procesverbalin e kontrollit të kryer.

Përgjigja ndaj kundërshtimit të përmendur në paragrafin 1 të kësaj pike i paraqitet bankës brenda njëzet e pesë ditëve nga marrja e kundërshtimit. Në përgjigjen e kundërshtimit, personat e autorizuar e informojnë bankën edhe për çdo ndryshim të mundshëm në planin e veprimtarive të përmendura në pikën 25, paragrafin 2 të këtij vendimi.

27. Nëse procesverbalin e kontrollit të kryer përmban gjetje që kanë të bëjnë me punën e shoqërisë së auditimit, një ekstrakt nga procesverbalin e kontrollit të kryer duhet t'i dorëzohet edhe shoqërisë së auditimit.

Shoqëria e auditimit nga paragrafi 1 i kësaj pike ka të drejtë ta kundërshtojë procesverbalin e kontrollit të kryer, brenda tetë ditësh nga marrja e ekstraktit të procesverbalit të kontrollit të kryer.

Pas marrjes së kundërshtimit të shoqërisë së auditimit, personat e autorizuar detyrohen të veprojnë sipas pikës 26 të këtij vendimi.

28. Pas paraqitjes së përgjigjes për kundërshtimin nga pikat 26 dhe 27 të këtij vendimi, kontrolli në terren konsiderohet i përfunduar, dhe procesverbalin e kontrollit të kryer konsiderohet si përfundimtar. Përgjigjet për kundërshtimet nga pikat 26 dhe 27 të këtij vendimi janë pjesë përbërëse e procesverbalit përfundimtar të kontrollit të kryer.

Një kopje e procesverbalit përfundimtar të kontrollit të kryer i dërgohet kryetarit të këshillit mbikëqyrës të bankës, me kërkesë që të shqyrtohet nga anëtarët e këshillit mbikëqyrës në seancën e parë të radhës.

29. Në bazë të procesverbalit përfundimtar të kontrollit të kryer, personat e autorizuar mund të hartojnë një letër drejtuar anëtarëve të bordit drejtues të bankës, e cila do të përfshijë një vlerësim përmbledhës të sigurisë, stabilitetit dhe rrezikshmërisë së funksionimit të bankës.

Letra nga paragrafi 1 i kësaj pike përbën sekret profesional të Bankës Popullore dhe banka është e detyruar ta ruajë atë. Banka mund ta citojë ose në ndonjë mënyrë tjetër ta specifikojë përmbajtjen e letrës nga paragrafi 1 i kësaj pike vetëm pasi të ketë marrë miratim paraprak me shkrim nga guvernatori i Bankës Popullore.

Një kopje e letrës së përmendur në paragrafin 1 të kësaj pike i dërgohet kryetarit të këshillit mbikëqyrës të bankës, me kërkesë që të shqyrtohet nga anëtarët e këshillit mbikëqyrës në seancën e parë të radhës.

30. Kryetari i këshillit mbikëqyrës është i detyruar t'ia dorëzojë Bankës Popullore procesverbalin e seancës së këshillit mbikëqyrës në të cilin është shqyrtuar procesverbali përfundimtar i kontrollit të kryer dhe letra e përmendur në pikën 29 të këtij vendimi, në të cilët duhet të nënshkruhen të gjithë anëtarët e këshillit mbikëqyrës që kanë marrë pjesë në seancë, duke konfirmuar se janë njohur me përmbajtjen e procesverbalit përfundimtar dhe letrën dhe me aktivitetet që banka duhet t'i ndërmarë për t'i tejkaluar dobësitë, mangësitë apo mospërputhjet e konstatuara.

Personat e autorizuar mund të marrin pjesë në seancën e këshillit mbikëqyrës, në të cilin shqyrtohet procesverbali përfundimtar i kontrollit të kryer dhe letra nga pika 29 e këtij vendimi.

Kontrolli inspektues

31. Kontrolli inspektues kryhet sipas një plani kontrolli të paracaktuar, të miratuar nga guvernatori i Bankës Popullore, ose sipas nevojës nëse me supervizionin e jashtëm konstatohet se banka nuk funksionon në përputhje me rregulloret.

32. Pas kryerjes së kontrollit inspektues, personat e autorizuar të përmendur në pikën 14, paragrafin 2, të këtij vendimi përpilojnë procesverbal për kontrollin inspektues të kryer.

33. Në procesverbalin e kontrollit inspektues të kryer dhe në procedurën deri në përfundimin e saj, zbatohen në përputhje me rrethanat dispozitat e pikave 23, 24, 25, 26, 28 dhe 30 të këtij vendimi.

Me përjashtim të paragrafit 1 të kësaj pike:

- banka ka të drejtë ta kundërshtojë procesverbalin e kontrollit inspektues brenda afatit të caktuar nga Banka Popullore, i cili nuk mund të jetë më i shkurtër se pesë ditë e as më i gjatë se dhjetë ditë;

- personat e autorizuar janë të detyruar ta paraqesin përgjigjen e kundërshtimit për procesverbalin e kontrollit inspektues të kryer brenda pesëmbëdhjetë ditëve nga marrja e kundërshtimit.

V. MBAJTJA E KONTAKTEVE ME ANËTARËT E ORGANEVE TË BANKËS DHE ME SHOQËRINË E AUDITIMIT

34. Krahas kontakteve me anëtarët e organeve të bankës të përcaktuara në kapitujt III dhe IV të këtij vendimi, në përputhje me nevojat, personat e autorizuar do të zhvillojnë takime me anëtarë të bordit drejtues, anëtarë të këshillit mbikëqyrës, anëtarë të bordit të auditimit, punonjës të sektorit për auditim të brendshëm, persona përgjegjës për funksionin e kontrollit të përputhshmërisë së veprimeve të bankës me rregulloret dhe për funksionin e administrimit të rrezikut dhe me shoqërinë e auditimit.

Qëllimi i këtyre takimeve është shkëmbimi i të dhënave dhe informacioneve për bankën, në mënyrë që personat e autorizuar të marrin informacion më të detajuar për drejtimin korporativ, rreziqet ndaj të cilave ekspozohet banka në veprimtarinë e saj dhe mënyrën e menaxhimit të tyre, ndryshimet në politikën e biznesit të bankës dhe çështje të tjera që lidhen me sigurinë dhe stabilitetin e bankës.

35. Përpara fillimit të inspektimit në teren, personat e autorizuar të përmendur në pikën 14, paragrafin 2 të këtij vendimi mund të zhvillojnë takim me shërbimin për auditim të brendshëm dhe me shoqërinë për auditim.

Në takim diskutohen gjetjet nga aktivitetet e shërbimit për auditim të brendshëm dhe shoqërisë për auditim të caktuar nga banka.

VI. BASHKËPUNIMI DHE SHKËMBIMI I TË DHËNAVE DHE INFORMACIONEVE ME ORGANET E TJERA TË SUPERVIZIONIT

36. Për nevojat e supervizionit, personat e autorizuar bashkëpunojnë dhe shkëmbejnë të dhëna dhe informata me organe të tjera të supervizionit në Republikën e Maqedonisë dhe jashtë saj, në pajtim me ligjin.

VII. MËNYRA E KRYERJES SË MBIKËQYRJES

37. Banka Popullore mund t'i mbikëqyrë veprimet e personave të lidhur me bankën, të personave të tjerë në grupin bankar ose të kompanisë për shërbime ndihmëse të bankës (në tekstin e mëtejme: subjekte të mbikëqyrjes).

Nëse personat nga paragrafi 1 i kësaj pike i nënshtrohen kontrollit nga ana e një organi tjetër të autorizuar, Banka Popullore mbikëqyrjen nga paragrafi 1 i kësaj pike e kryen në bashkëpunim me atë organ.

Mbikëqyrja nga paragrafi 1 i kësaj pike do të kryhet në bazë të autorizimit me shkrim nga guvernatori i Bankës Popullore, me të cilin përcaktohet subjekti i mbikëqyrjes dhe personat e autorizuar.

38. Banka Popullore u dërgon njoftim subjekteve të mbikëqyrura se planifikon të kryejë mbikëqyrje, jo më vonë se 8 ditë para fillimit të mbikëqyrjes.

Në njoftimin nga paragrafi 1 i këtij neni zbatohen përkatësisht dispozitat e pikës 18 të këtij vendimi.

39. Subjektet e mbikëqyrura janë të detyruara t'u mundësojnë personave të autorizuar të përmendur në pikën 37, paragrafin 2 të këtij vendimi, që ta kryejnë pa pengesë mbikëqyrjen, të kenë kontroll mbi operacionet dhe, me kërkesën e tyre, t'ua vënë në dispozicion ose t'ua paraqesin të gjithë dokumentacionin, të dhënat dhe informacionin e nevojshëm.

40. Pas përfundimit të mbikëqyrjes, personat e autorizuar të përmendur në pikën 37, paragrafin 2 të këtij vendimi përgatisin raport për mbikëqyrjen e kryer.

41. Subjekti i mbikëqyrur ka të drejtë të kundërshtojë brenda një afati jo më të gjatë se tetë ditë nga data e marrjes së raportit për mbikëqyrjen e kryer, ku jep shpjegim me prova të dokumentuara për konstatimet që i konsideron të pabazuara ose që nuk korrespondojnë me gjendjen faktike.

Personat e autorizuar nga pika 37, paragrafi 2 i këtij vendimi janë të detyruar ta shqyrtojnë kundërshtimin nga paragrafi 1 i kësaj pike, të përgatisin përgjigje ndaj kundërshtimit në të cilën deklarohen për (mos)pranimin e shpjegimeve të veçanta të subjektit të mbikëqyrjes dhe përgjigjen për kundërshtimin t'ia paraqesin subjektit të mbikëqyrjes brenda pesëmbëdhjetë ditëve nga marrja e kundërshtimit.

Pas paraqitjes së përgjigjes për kundërshtimin nga paragrafi 2 i kësaj pike, mbikëqyrja konsiderohet e përfunduar, dhe raporti për mbikëqyrjen e kryer konsiderohet përfundimtar.

42. Pas përfundimit të raportit, Banka Popullore e njofton bankën që është e ndërlidhur me subjektin e mbikëqyrur ose që i përdor shërbimet e subjektit të mbikëqyrur për gjetjet specifike që mund të kenë ndikim në funksionimin apo rrezikshmërinë e saj.

VIII. DISPOZITA KALIMTARE DHE PËRFUNDIMTARE

43. Dispozitat e këtij vendimi në mënyrë të përshtatshme do të zbatohen edhe gjatë supervizionit të kursimoreve, filialeve të bankave nga shtetet anëtare të Bashkimit Evropian, filialeve të bankave të huaja dhe filialeve të bankave nga Republika e Maqedonisë jashtë vendit.

44. Në ditën e hyrjes në fuqi të këtij vendimi, pushon së qeni i vlefshëm Vendimi për mënyrën e kryerjes së supervizionit dhe mbikëqyrjes ("Gazeta Zyrtare e Republikës së Maqedonisë" nr. 31/08, 74/12, 100/12 dhe 170/17).

Ky vendim hyn në fuqi në ditën e tetë nga dita e publikimit në "Gazetën Zyrtare të Republikës së Maqedonisë".

V. nr. 02-15/VI-1/2018
29 mars 2018
Shkup

Guvernator
dhe kryesues
i Këshillit të Bankës Popullore
të Republikës së Maqedonisë
Dimitar Bogov